



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2460/ 9 prot.

Datë .17/11/2023

V E N D I M
Nr. 1178 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës .17/11/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur Marrëveshje Kuadër*” me nr. REF-74324-07-05-2023 me objekt: “Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II”, me fond limit 208 333 221 (*dyqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e një*) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

“ALBAVIA” SHPK me NIPT J81527001Q dhe adresë, *Rruga: “Sulejman Delvina”, Pallati Fati, shk.1, ap.19, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit me adresë *Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.*

Subjekt i interesuar:

“VELLEZERIT HYSA” SHPK, me NIPT K12911201C dhe adresë Klos Elbasan, Fshati Banjë e Re, Klos, Bashkia Cërrik, buze lumit Devoll, 500 m nga ura mbi lumin Devoll, zona kadastrale.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operator ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.07.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur Marrëveshje Kuadër*” me nr. REF-74324-07-05-2023 me objekt: “Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II”, me fond limit 208 333 221 (*dyqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e një*) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 24.07.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 22.09.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “VELLEZERIT HYSA” ShPK., vlera 159 327 500 lekë pa TVSh, totali i pikëve të marra - 267,15 - kualifikuar
2. BOE “BE – IS” ShPK & “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN”, vlera 176 260 619 lekë pa TVSh, totali i pikëve të marra - 232,95 - kualifikuar
3. OE “FUSHA” ShPK, vlera 181 946 576,80 lekë pa TVSh, totali i pikëve të marra - 211,80 - kualifikuar
4. OE “GJIKURIA” ShPK, vlera 205 953 400 lekë pa TVSh, totali i pikëve të marra - 210,45 - kualifikuar
5. OE “G.P.G. COMPANY” ShPK, vlera 169 974 790 lekë pa TVSh, totali i pikëve të marra 192,45 - kualifikuar
6. BOE “EUROKOS HOLDING ShPK DEGA NE SHQIPERI” Dege e shoqërisë së huaj & “ABI CONS” vlera 156 544 800 lekë pa TVSh, - skualifikuar
7. BOE “Shendelli” & "METEO" ShPK & TOTILA ShPK vlera 204 339 400 lekë pa TVSh, - skualifikuar
8. OE “S I R E T A 2F” ShPK vlera 161 616 161 lekë pa TVSh, - skualifikuar
9. OE “KTHELLA” vlera 167 563 685 lekë pa TVSh, - skualifikuar
- 10. OE “ALBAVIA” vlera 158 142 800 lekë pa TVSh, - skualifikuar**

II.4. Në datën 02.10.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 84, datë 09.10.2023.

II.5. Operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

“Operatori ekonomik “Albavia” ShPK nuk plotëson kriterin teknik 2.3.1 të DST, për kapacitetin teknik, ku parashikohet se Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht, elementet e kërkuar për këtë procedurë prokurimi si të ngjashëm nuk plotësohen si pjesë e kontratave të punimeve të paraqitura nga operatori ekonomik, në vijim duke shkeputur zërat e punimeve si urat etj. të kontratave të paraqitura brenda afatit të

kërkuar nuk e arrin vlerën e kërkuar sikurse të përcaktuar në pikën 2.3.1 (a) dhe 2.3.1 (b) të Dokumenteve Standarde të tenderit (Ndërrhyrje në Ndërtimin e Urave dhe Nyjeve Lidhëse Faza II). Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues”.

II.6. Në datën 09.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3476 dhe me nr. 2460/2023 prot., datë 09.10.2023, e operatorit ekonomik “ALBAVIA” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

Pretendimet janë si më poshtë vijon:

“Referuar LPP dhe VKM, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Shoqëria ALBAVIA, me qëllim përmbushjen e këtij kriteri i ka paraqitur për vlerësim FSHZH-se; A. Kontratën Nr. 1195/6 date 17.05.2023 me objekt: “Ndërtimi I rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut-Bregu I Lumit) loti 2”. B. Kontratën nr. 6999/5 datë 10.10.2018 me objekt “Rikualifikimi I akseve rrugore të Unazës Lindore, Loti 2” C. Kontratën Nr. 03 datë 14.10.2017 me objekt: “Ndërtim I rrugës Qukës -Qafë Plloce, Segmenti I korridorit Tiranë Korçë, Seksioni 1: nga km 2.9 në km 18. Lidhur me Kontratën Nr. 1195/6 datë 17.05.2023 me objekt: “Ndërtimi I rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut-Bregu I Lumit) loti 2, ALBAVIA ka dorëzuar në SPE: 1. Vërtetimin e lëshuar nga Autoritetin Rrugor Shqiptar për përmbushjen me sukses të Kontratës Nr. 1195/6 datë 17.05.2023 me objekt: Ndërtimi I rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut-Bregu I Lumit) loti 2 (referuar në vijim Kontrata), në vlerën 2,327,878,493 lekë me TVSH, përfunduar me datë 14.11.2022 dhe datë kolaudimi me 05.12.2022 2. Gjithashtu, Shoqëria Albavia i ka paraqitur FSHZH edhe Kontratën e lartpërmendur me preventivin, 3. Situacionin Përfundimtar Tetor 2022, 4. Procesverbalin e Kolaudimit të objektit të kontratës, 5. Faturat Tatimore të shitjes lëshuar përgjatë zbatimit të Kontratës Sikurse citon edhe FSHZH në argumentin e refuzimit të ofertës se Albavia, objektet/kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Konkretisht, Kontrata e paraqitur nga Albavia si punë e ngjashme për vlerësim nga FSHZH, I përmbush kumulativisht elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme, sepse: 1. Për Elementin Kohë: a. Kontrata, megjithëse është lidhur në vitin 2013, ka përfunduar me datë

14.11.2022, provuar me: i. Vërtetimin e lëshuar nga Porositësit (ARRSH), ku specifikohet data 14.11.2022 e përfundimit të punimeve ii. Situacionin Përfundimtar me Tetor 2022 iii. Akti i Kolaudimit datë 05.12.2022 iv. Aktin e Marrjes në dorëzim v. Dorëzimit të informacionit të përmbledhur sipas formatit bashkëlidhur procedurë konkurruese (Aneks 2) vi. Fatura Tatimore shitje të realizuar gjatë periudhës 2018-2022 2. Për Elementin Vlerë a. Vlera e Kontratës është 2,327,878,493 lekë me TVSH lekë, prej të cilave vlera e punimeve të kryera gjatë periudhës Gusht 2018 - Tetor 2022 është në shumën 1,481,431,761 lekë pa TVSH, siç provohet nga: i. Situacionin Përfundimtar Tetor 2022 ii. Akti i Kolaudimit datë 05.12.2022 iii. Dorëzimit të informacionit të përmbledhur sipas formatit bashkëlidhur procedure konkurruese (Aneks 2) iv. Fatura Tatimore shitje të realizuar gjatë periudhës 2018-2022, ku vetëm vlera e 2 fatura të marra me përzgjedhje rastësore është në vlerën 312,903,036 Lekë pa TVSH dhe konkretisht Fatura Nr. 10 datë 31.03.2019 në vlerën 167,035,145 Lekë pa TVSH për situacionin Nr. 10 si dhe fatura Nr. 1/2021 datë 17.03.2021 në vlerën 145,869,891 Lekë Pa TVSH për Situacionin Nr. 20, shkëputur nga 25 Situacione të kryera për këtë objekt. v. Preventivi i ripunuar i punimeve i Kontratës sipas Vendimit të Këshillit Teknik të ARrSh Nr. 52 datë 27/07/2018, në vlerën 1,939,904,616 Lekë pa TVSH 3. Për elementin natyrë e ngjashme a. Kontrata, në preventivin dhe situacionet e saj, ka të njëjtat kategori/zëra punimesh si ato të preventivit të njoftuar nga FSHZH të procedurës konkurruese. Për më tepër Punimet e Ngjashme Specifike, megjithëse në DST theksohet se nuk konsiderohen si element skualifikues, janë kryer nga ALBAVIA gjate 5 viteve të fundit duke e tejkaluar me mbi katër apo pesë fish sasinë e zërave të kërkuar nga FSHZH në procedurën konkurruese, siç provohet me: i. Dorëzimit të informacionit të përmbledhur sipas formatit bashkëlidhur procedure konkurruese (Aneks 2) ii. Situacionin Përfundimtar me Tetor 2022 iii. Akti i Kolaudimit datë 05.12.2022, në të cilin përshkruhen detaje të punëve të ngjashme kur rezultojnë punimet e kryera për nyjet lidhëse dhe veprat e artit të mëdha. iv. Preventivi i ripunuar i punimeve i Kontratës sipas Vendimit të Këshillit Teknik të ARrSh Nr. 52 datë 27/07/2018, në vlerën 1,939,904,616 Lekë pa TVSH. Nga Kontrata dhe aktet pjesë e saj e dorëzuar nga Albavia, për vlerësim nga FSHZH, rezulton që vetëm në periudhën nga Gushti i vitit 2018 deri në Tetor të vitit 2022, në zërin B-2 “Ndërtim Vepra Arti të Mëdha” (H.D. 10-30ml) vlera e punimeve e kryer është 719.061.787 lekë pa TVSh. Ky kapitull preventivi, i realizuar përgjatë kësaj periudhe (lartpërmendur), përmban vetëm punimet e ngjashme në Ura ku përfshihet edhe sasia e betoneve të kërkuara, vlera këto që tejkalojnë katërcipërisht çdo vlerë referuese dhënë nga FSHZH në DST për tu përmbushur nga . Kapitujt e tjerë të realizuar gjatë kësaj periudhe e përforcojnë provën e punimeve të ngjashme të realizuara nga Albavia gjatë periudhës së 5-vjecarit të fundit. Megjithëse mjafton vetëm Kontrata e lartpërmendur për të përmbushur kumulativisht elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme, megjithatë, Albavia ka dorëzuar në SPE, me qëllim për ti shfaqur FSHZH eksperiencën e punëve të ngjashme, edhe dy kontrata të tjera. I njëjti argumentim i dhënë për kontratën më lart për punët e ngjashme, qëndron dhe provohet me dokumentacionin e dorëzuar në SPE për Kontratën nr. 6999/5 datë 10.10.2018 me objekt “Rikualifikimi i akseve rrugore të Unazës Lindore, Loti 2” dhe Kontratën Nr. 03 datë 14.10.2017 me objekt: “Ndërtim i rrugës Qukës - Qafë Plloce, Segmenti i korridorit Tiranë - Korçë, Seksioni 1: nga km 2.9 - km 18”, si dhe Kontratën me FSHZH me Nr.Ref CËPIV/Ë/OP/2016/9 datë 10.07.2017 . Albavia e përmbush kriterin 2.3.1

jo vetëm veçmas për çdo kontratë të dorëzuar në SPE por edhe duke i marrë ato së bashku. FSHZH është në kundërshtim me legjislacionin e fushës kur refuzon ofertën e ALBAVIA duke e përjashtuar ofertën e saj me argumentin se nuk ka punime të ngjashme, ndërkohë që paraqitja e këtij dokumenti është e provuar/konstatuar që ekziston në dokumentacionin e dorëzuar në SPE. Megjithëse FSHZH kishte detyrimin të verifikonte, nëse ishin dorëzuar nga ALBAVIA dokumentet konkrete/provuese për punët e ngjashme dhe ti vlerësonte ato, sipas nenit 77/5, 92/3 (LPP) nuk e ka bërë këtë. *neni 77/5 i LPP: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. *neni 92/3 të LPP: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.....” Edhe nëse FSHZH kishte paqartësi lidhur me vlerësimin e Punëve e Ngjashme të dorëzuar nga Albavia ashtu si dhe të vetëdeklaruarat prej saj në Aneksin 2, kishte mundësinë që të kërkonte sqarime në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM dhe paragrafit të fundit të nenit 82 të VKM. Gjithashtu, nuk duhet përjashtuar edhe vlerësimi që FSHZH duhet të bënte Aneksit Nr. 2 të kërkuar prej saj, situacionit përfundimtar dhe faturave tatimore të shitjes, qellimi i të cilave është që ti shërbejë FSHZH që të vlerësojë të vërtetë si provë paraprake të sa deklaruar nga operatori ekonomik (Albavia) dhe më pas të kërkojë sqarime apo edhe të vijojë me verifikimin duke kërkuar provën e sa deklaruar. Neni 26/7: Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”. Neni 82/2: Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë. Për sa më sipër, refuzimi i Ofertës së paraqitur nga ALBAVIA nuk është shkak i mbështetur në ligjin për Prokurimin Publik, aktin nënligjor në zbatim të tij dhe Dokumentet Standarde të Tenderit, Në Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese dhe në vetë Faktin që disponohet në provat e depozituara në SPE por, në rastin më të mirë, të paverifikuara prej FSHZH. Duke qenë se plotësojmë të gjitha kërkesat e DST rrjedhimisht kërkojmë KUALIFIKIMIN E OFERTËS se ALBAVIA për shkak se Oferta e Albavia është vlefshme dhe vijimin e procedurave”.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2460/2 prot., datë 10.10.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik

“ALBAVIA” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3476, dhe me numër protokoll 2460/2023, datë 09.10.2023.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 3265/2 prot., datë 16.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2460/3 prot., datë 18.10.2023 me lëndë “*Informacion*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor infomacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.9. Për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me shkresën nr. 2460/4 prot., datë 02.11.2023 Komisioni i Prokurimit Publik, vuri në dijeni autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik për shtyrje afati në shqyrtimin e ankesës.

II.10. Me shkresën nr. 2460/5 prot., datë 03.11.2023 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

II.11. Me shkresën nr. 2460/6 prot., datë 06.11.2023 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion Autoritetit Rrugor Shqiptar.

II.12. Me anë të shkresës nr. 3265/5 prot., datë 07.11.2023, të protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2460/7 prot., datë 08.11.2023, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar.

II.13. Me anë të shkresës nr. 8660/1 prot., datë 08.11.2023, të protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2460/8 prot., datë 08.11.2023, Autoritetit Rrugor Shqiptar ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar.

II.14. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALBAVIA” SHPK se: “*Operatori ekonomik “Albavia” ShPK nuk plotëson kriterin teknik 2.3.1 të DST, për kapacitetin teknik, ku parashikohet se Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme*”

të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht, elementet e kërkuar për këtë procedurë prokurimi si të ngjashëm nuk plotësohen si pjesë e kontratave të punimeve të paraqitura nga operatori ekonomik, në vijim duke shkëputur zërat e punimeve si urat etj. të kontratave të paraqitura brenda afatit të kërkuar nuk e arrin vlerën e kërkuar sikurse të përcaktuar në pikën 2.3.1 (a) dhe 2.3.1 (b) të Dokumenteve Standarde të tenderit (Ndërhyrje në Ndërtimin e Urave dhe Nyjeve Lidhëse Faza II). Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “ALBAVIA” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjithësisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ALBAVIA” SHPK, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht vëren se:

III.1.3. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

III.1.4. Në nenin Neni 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.5. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.1.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë

trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese

III.1.7. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimesit i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyetimin se plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit lidhur me kontratat e ngjashme (pika 2.3.1 të kapacitetit teknik), KPP vëren se në kriterin e veçantë të kualifikimit pika 2.3.1, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë, *duhet të paraqesin dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimesit të paraqitura në ankesë për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapaciteteve teknike, si dhe arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për vlerën limit të kontratave-punë të

ngjashme të realizuara, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis si dhe nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e aftësive teknike të mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave-pune të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë *jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.* Nga verifikimet rezulton, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në lidhje me vlerën limit të kontratave-pune të ngjashme të kryera nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022, e ndryshuar. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi, si dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë, në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme, parashikimet e nenit 39, pika 5 e aktit nënligjor të mësipërm, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

III.1.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]*”, gjykon se hartimi i kriterit të kualifikimit, jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ALBAVIA” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur Marrëveshje Kuadër*” me nr. REF-74324-07-05-2023 me objekt: “Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II”, me fond limit 208 333 221 (*dyqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e një*) lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaïd Myzyri

